



BASHKIA KORÇË

# **BUXHETI VJETOR 2019**

**NËNTOR 2018**



## BASHKIA KORÇË

Korça, qendra më e rëndësishme e juglindjes së Shqipërisë, prej vitesh tashmë ka hyrë në një rrugë të konsoliduar të zhvillimit të saj. Me politikat, programet dhe projektet e hartuara dhe zbatuara në këto vite, qyteti dhe fshatrat që janë pjesë e kësaj bashkie, po njohin nga viti në vit transformimin urban dhe ekonomik, duke ofruar kushte më të mira jetese dhe mundësi të shtuara për banorët e këtij lokaliteti.

Vizioni i qartë i zhvillimit, projektet e zbatuara, menaxhimi me efikasitet i të ardhurave, stafi i kualifikuar i bashkisë dhe bashkëpunimi me komunitetin, ka bërë të mundur që Korça sot të ofrojë mundësi jo vetëm për banorët e saj, por edhe të jetë një nga destinacionet më të preferuara të vizitorëve vendas e të huaj.

Në planifikimin buxhetor, bashkia ka prioritarizuar çdo vit përmirësimin e infrastrukturës, me investime të shumta në qytet e fshat, duke rivitalizuar dhe kthyer në identitet, vlera të çmuara të trashëgimisë urbane, që e dallojnë Korçën nga pjesët e tjera të Shqipërisë, si edhe duke krijuar vlera të reja të cilat i kanë dhënë Korçës një dimension të ri.

Korça sot, falë këtyre investimeve të rëndësishme të bashkisë, nuk krenohet thjesht me të shkuarën e saj, por është një lokalitet që rritet e zhvillohet.

Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore me shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve dhe projektin e madh të ujësjellësit, i cili siguroi 24 orë ujë të pijshëm në çdo familje korçare, i hapi rrugën në këto vite përmirësimit të mëtejshëm infrastrukturor në rrugë e bulevarde, lagje tradicionale, sheshe e blloqe banimi, godina e parqe, duke bërë që Korça të jetë një nga bashkitë me infrastrukturën më të përmirësuar në Shqipëri.

Pas përmirësimit infrastrukturor në pjesën më të madhe të qytetit, shumë projekte në vijim janë përqëndruar në shtrirjen e këtij standarti edhe në fshatrat që tashmë janë pjesë e administrimit të bashkisë.

Veç ndërhyrjeve në infrastrukturë, bashkia ka orjentuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit, institucione të dedikuara, çerdhe, kopshte, shkolla, qendra shëndetësore, qendra për moshën e tretë, mbështetje për njerëzit në nevojë, duke i qëndruar kështu më pranë nevojave të banorëve.

Zhvillimi i turizmit në këto vitë ka qenë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për Korçën.



## BASHKIA KORÇË

Numri gjithnjë në rritje i vizitorëve ka shtuar jo vetëm numrin e bizneseve të shërbimit turistik dhe të ardhurat për ofruesit e këtyre shërbimeve, por ka imponuar edhe nevojën e orjentimit të një pjesë të rëndësishme të buxhetit të bashkisë në drejtim të mbështetjes për turizmin.

Përmirësimi i infrastrukturës në zonat turistike, një paketë e plotë eventesh në qytet dhe fshat, e shtrirë në të gjithë muajt e vitit, një kalendar i pasur me aktivitete kulturore e sportive jo vetëm lokale, por edhe kombëtare e ndërkombëtare, kanë për qëllim jo vetëm ruajtjen dhe promovimin e vlerave më të mira të traditës, por sidomos promovimin e Korçës si një nga qendrat më të rëndësishme kulturore e turistike në Shqipëri.

Me administrimin efektiv të buxhetit të saj si edhe me mbështetjen e qeverisë dhe donatorëve, Bashkia Korçë edhe gjatë vitit 2019 do të zbatojë programe e projekte të rëndësishme zhvillimi, pjesë e vizionit të saj strategjik për zhvillimin e Korçës dhe përmirësimin e jetesës së banorëve në qytet dhe fshat.






## BASHKIA KORÇË

### *Pozita Gjeografike:*

Bashkia e Korçës shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë, në Krahinën Malore Qendrore. Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Shtrihet në pjesën Juglindore të vendit, në rrëzë të malit të Moravës, në lartësinë 869 metra mbi nivelin e detit. Relievi është kryesisht malor e kodrinor. Lartësia mesatare është 1145 metra. Korça, si rajon, është e rrethuar nga një numër i konsiderueshëm kodrash e malesh, në lindje qyteti kufizohet me malin e Moravës dhe në perëndim me zonën e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, të cilat janë zonat më malore. Në jug ndodhet Mali i Qarrit dhe në pjesën veriore është Mali i Thatë. Zona e ulët përfshin fushën e Korçës, një ndër më të mëdhatë e Shqipërisë dhe fushën e Devollit të Sipërm.

Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishmi është lumi i Devollit me degën Dunavec dhe Osumi i Sipërm. Në këtë zonë gjenden burimet e tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum). Liqenet janë Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël.

Korça kufizohet në veri me qytetin e Pogradecit i cili ndodhet 41 kilometra, në jug me qytetin e Ersekës, 45 kilometra, në lindje me Bilishtin, 27 kilometra, dhe në perëndim me Skraparin. Qyteti i Korçës ndodhet 181 kilometra larg kryeqytetit të vendit, Tiranës.





## BASHKIA KORÇË

### *Popullsia:*

Bashkia Korçë ka 130 531 banorë dhe një sipërfaqe prej 805.99 km<sup>2</sup>.

Bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë.

Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe Qarkut Korçë.

Bashkia ka nën administrimin e saj 1 (një ) qytet dhe 62 (gjashtëdhjetë e dy) fshatra.

Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta.

Zonat rurale, pjesë e bashkisë, merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori, por pjesë e bashkisë janë edhe disa fshatra turistikë. Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët ofrojnë ambiente akomoduese dhe shërbimi por edhe aktiviteteteve dimërore si një atraksion i shtuar për turistët.





## BASHKIA KORÇË

### **Përmbajtja e buxhetit vjetor 2019**

Hyrje.....	9
1.Kuadri ligjor .....	9
2.Parime të autonomisë fiskale.....	10
3. Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2019 .....	11
4. Të ardhurat e veta të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.....	11
4.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore .....	12
4.2 Të ardhurat nga institucionet e vartësisë .....	35
5. Transfertat nga buxheti i shtetit.....	36
5.1. Transferata e pakushtëzuar 2019.....	36
5.2. Transfertat e pakushtëzuara sektoriale .....	37
5.3. Transferata të kushtëzuara.....	38
5.4. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.....	38
6. Buxheti 2019 .....	39
6.1. Dokumentacioni bazë .....	41
6.2. Dokumentacioni shoqërues .....	45
7. Detajimi i buxhetit të Bashkisë sipas programeve .....	48
7.1. Organet ekzekutive dhe legjislative për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme 011 .....	48
7.1.1. Programi:Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110.....	48
7.1.2. Programi:Çështjet financiare dhe fiskale 01120 .....	52
7.2. Shërbime të huamarrjes vendore 017 .....	53
Programi:Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm 01710 .....	53
7.3. Shërbime policore 031.....	56
Programi:Shërbimet e policisë vendore 03140 .....	56
7.4. Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit 032 .....	57
Programi:Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile 03280.....	57
7.5. Çështjet e përgjithshme ekonomike tregëtare dhe të punës 041 .....	59
Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik 04130 .....	59
7.6. Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia 042.....	60
Programi: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve 04220 .....	60
7.7. Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia 042.....	61



## BASHKIA KORÇË

Programi: Administrimi i pyjeve dhe kullotave 04260 .....	61
7.8. Transporti 045 .....	62
Programi: Rrjeti rrugor rural 04520 .....	62
7.9. Transporti 045 .....	63
Programi: Transporti publik 04570 .....	63
7.10. Industri të tjera 047.....	65
Programi: Zhvillimi i turizmit 04760 .....	65
7.11. Fondi rezervë 04910.....	69
7.12. Fondi i kontigjencës 04940 .....	70
7.13. Menaxhimi i mbetjeve 051 .....	70
Programi: Menaxhimi imbetjeve 05100.....	70
7.14. Mbrojtja e mjedisit 056 .....	72
Programi: Ndërgjegjësimi mjedisor 05630 .....	72
7.15. Urbanistika 061 .....	74
Programi: Planifikimi urban vendor 06140.....	74
7.16. Zhvillimi i komunitetit 062 .....	75
Programi: Shërbime publike vendore 06260.....	75
7.17. Shërbimet rekreative dhe sportive 081 .....	76
Programi: Sport dhe argëtim 08130 .....	76
7.18. Arsimit bazë dhe parashkollor 091 .....	80
Programi: Arsimit bazë dhe parashkollor 09120.....	80
7.19. Të moshuarit 102.....	82
Programi: Sigurimi shoqëror 10220 .....	82
7.20. Sëmundje dhe paaftësi 101 .....	85
Programi: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140.....	85
7.21. Familje dhe fëmijët 104.....	87
Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430.....	87
7.22. Strehimi social 106.....	91
Programi: Strehimi social 10661 .....	91
8. Buxheti 2019 për institucionet e varësisë.....	99
8.1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike .....	99
8.1.1. Buqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia 042.....	99
Programi: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 04240 .....	99



## BASHKIA KORÇË

8.1.2Transporti 045 .....	101
Programi: Rrjeti rrugor rural 04520 .....	101
8.1.3. Zhvillimi i komunitetit 062 .....	102
Programi: Shërbime publike vendore 06260.....	102
8.1.4.Ndriçimi i rrugëve 064 .....	108
Programi: Ndriçim rrugësh 06440.....	108
8.2.Klubi Shumësportësh .....	110
8.2.1. Shërbime rekreative dhe sportive 081 .....	110
Programi:Sport dhe argëtim 08130 .....	110
8.3. Qendra e Artit dhe Kulturës .....	114
8.3.1 Shërbime kulturore 082 .....	114
Programi: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 08220 .....	114
8.4. Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes.....	119
8.4.1. Arsimi bazë dhe parashkollor 091 .....	120
Programi: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor 09120 .....	120
8.4.2. Arsimi parauniversitar 092.....	127
Programi: Arsimi i mesëm i përgjithshëm 09230 .....	127
8.4.3. Arsimi parauniversitar 092 .....	130
Programi: Arsimi profesional 09240.....	130
8.4.4. Familja dhe fëmijët 104.....	131
Programi:Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430.....	131
8.5. Qendra Ditore dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.....	135
8.5.1. Sëmundje dhe paaftësi 101.....	135
Programi:Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140.....	135
8.6.Shtëpia e Foshnjës .....	137
8.6.1. Familja dhe fëmijë 104.....	137
Programi:Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430.....	137
8.7. Njësia e Menxhimit të Banesave me Qëllim Social .....	138
8.7.1. Strehimi social 106.....	138
Programi:Strehimi social 10661 .....	138
9.Të tjera.....	140
9.1 Tabela e të ardhurave të institucioneve për vitin 2019 .....	140
9.2 Realizimi 11 mujori shpenzimeve për investime për Bashkinë.....	140



## BASHKIA KORÇË

### Hyrje

Buxheti 2019 dhe PBA 2019-2021 bazohen tek ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Ky buxhet bazohet në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Buxheti është dokumenti që përmbledh tërësinë e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve, i miratuar nga KB e NJQV. Buxheti ka në përmbajtjen e tij karakteristikat e mëposhtme:

- **Dokument bazë i politikave**, planifikimit dhe kontrollit;
- **Kontratë** ndërmjet qytetarëve dhe të zgjedhurve vendorë;
- **Mjet komunikimi** me komunitetin dhe grupet e interesit;
- **Udhërrëfyes** drejt përmbushjes së objektivave;
- **Optimalizon** përdorimin e burimeve financiare në dispozicion;
- **Promovon** pjesëmarrjen e grupeve të interesit në qeverisje;
- **Mjet për matjen e arritjeve** kundrejt objektivave apo premtimeve.

### 1.Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;



## BASHKIA KORÇË

- Udhëzimi i MF nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA-së”, të NJQV;
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;i ndryshuar
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

### **2. Parime të autonomisë fiskale**

1. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.
2. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar transfertë të pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit, e cila ndahet sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.
3. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare dhe tatimet, të cilat ndahen sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të veta, të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave nga taksat e ndara.
5. Propozimet e qeverisjes qendrore për ndryshime në legjislacion, me efekt pakësimin e nivelit dhe/ose të llojeve të të ardhurave vendore dhe/ose transferimin e funksioneve ose kompetencave në nivel vendor, konsultohen paraprakisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6. Në rastet kur ulen apo hiqen taksa ose tarifa vendore nga qeverisja qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen plotësisht, nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar, taksave të ndara, transferimit në nivel vendor të një takse tjetër kombëtare ose kombinimi i tyre.
7. Funksionet ose kompetencat që u transferohen apo delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe vendosja e një standardi të ri kombëtar për kryerjen e funksioneve ose kompetencave, shoqërohen kurdoherë me mjetet dhe burimet e nevojshme financiare për ushtrimin e tyre.



## BASHKIA KORÇË

### **3. Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2019**

Thellimi i decentralizimit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të shërbimeve. Viti 2019, do të jetë viti i implementimit të plotë të të gjithë instrumentave të reja të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore duke konsoliduar burimet e financimit dhe sigurojnë një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si:

- udhëzimeve të procedurave standarte për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe të monitorimit të buxhetit vendor;
- përdorimi i një instrumenti të ri për planifikimin financiar dhe hartimin e programit buxhetor afatmesëm që standartizon mënyrën e paraqitjes së informacionit buxhetor;
- unifikimi i programeve buxhetore të standartizuara për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- mbështetja dhe monitorimi i procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë vetëqeverisjes vendore;
- zhvillimi i seancave degjimore dhe konsultative midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore; si dhe
- hyrja në fuqi e udhëzimit për vështirësitë financiare të njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Këto masa, për vitin 2019 dhe në vazhdim, rrisin autonominë financiare dhe për rrjedhojë më shumë fonde për njësitë e vetëqeverisjes vendore, garantojnë më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparencë të buxheteve vendore dhe njëkohësisht disiplinë financiare dhe mirëmenaxhim të financave publike në nivel vendor.

### **4. Të ardhurat e veta të Njësisive të Vetëqeverisjes Vendore**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet



## BASHKIA KORÇË

që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

### **4.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Taksat vendore mund të klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:
  - a) taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
  - b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
  - c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
  - d) taksa e tabelës;
  - e) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
  - f) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
  - g) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
  - h) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

### **PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2019**

Planifikimi i të ardhurave për Bashkinë Korçë është i mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave dhe tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Planifikimi i vitit 2019 mbështetet në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të taksave dhe tarifave.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2019 reflekton ndryshimet në paketat fiskale të viteve të mëparshme dhe të asaj aktuale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve. Në këtë planifikim janë marrë në konsideratë:



## BASHKIA KORÇË

- Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi, zbatimi rigoroz i masave shtërnguese, monitorimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja).
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët.
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Mbështetur në legjislacion dhe në vendimet e Këshillit të Bashkisë, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e të Ardhurave
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e Kontrollit të Territorit
- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit të Bashkisë
  - Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV, Tatimin mbi të ardhurat personale dhe renta minerare.
  - D.R.SH.T.RR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura.
  - Z.V.R.P.P, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
  - U.K.KO Sha, për arkëtimin e taksave dhe tarifave lokale familjare.
  - Alben 2 Security, për arkëtimin e tarifës së parkimit me pagesë për vendet e miratuara me V.K.B.

Drejtoritë e Bashkisë janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë Korçë, të cilat jo vetëm arkëtojnë por dhe monitorojnë të gjitha strukturat e tjera.

Në mënyrë të detajuar realizimi i vitit 2017, planifikimi i vitit 2018, realizimi 11 -muor i vitit 2018, realizimi i pritshëm i vitit 2018 dhe planifikimi për vitin 2019 në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë e Korçës, paraqitet si më poshtë:



BASHKIA KORÇË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Realizim 2017	Plani 2018	Realiz.11muaj '18	I pritshëm 2018	2019
1	Taksë mbi ndërtesën	103,192,896	140,082,000	95,314,439	104,365,881	140,000,000
2	Taksë mbi truallin	6,119,732	7,500,000	8,689,560	9,000,000	9,000,000
3	Taksë mbi tokën bujqësore	20,816,412	37,230,000	18,227,661	27,582,545	40,000,000
4	Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	7,389,180	13,000,000	8,523,069	9,010,046	13,000,000
5	Taksë rregjistrimi e përvitshme (automjete)	24,619,201	42,500,000	33,218,631	36,490,736	42,000,000
6	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	6,728,100	32,200,000	5,064,782	5,480,604	23,000,000
7	Taksë për ndërtimet e reja	59,139,584	230,000,000	57,211,335	60,000,000	240,000,000
8	Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	15,711,598	37,000,000	24,321,740	25,440,494	40,000,000
9	Taksë fjetje në hotel	3,931,249	4,200,000	4,406,110	4,927,090	5,500,000
10	Taksë table	13,361,853	14,173,000	9,365,986	9,521,391	13,000,000
11	Taksë ndik.infrastrukturë Ministria e Energjisë	11,624,815	12,200,000	1,958,811	2,000,000	16,000,000
12	Dividenti nga U.K.KO	4,433,134	4,500,000	7,864,515	7,864,515	9,000,000
13	Dividenti nga Tregu i Shumicës	1,233,662	1,200,000	0	0	1,600,000
14	Renta minerare	74,247	100,000	108,291	126,535	200,000
15	Tarifë regjistrimi për leje transporti	2,562,060	3,700,000	1,057,930	1,646,930	2,600,000
16	Tarifë therje bagëti	1,034,950	1,000,000	2,077,850	2,728,400	3,000,000
17	Tarifë mur perimetral	570,146	1,450,000	597,492	650,000	1,500,000
18	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	3,529,420	1,900,000	782,100	812,400	862,500
19	Tarifë pastrimi	112,670,439	165,261,000	146,371,430	160,515,809	178,500,000
20	Tarifë ndriçimi	36,266,541	41,101,667	35,680,230	39,744,693	43,500,000
21	Tarifë gjelbërimi	23,683,772	28,383,500	23,488,618	25,000,000	31,000,000
22	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	12,908,387	16,150,000	13,140,388	13,931,905	18,000,000
23	Tarifë zënie hapësire publike	9,184,159	17,800,000	13,973,851	15,000,000	27,800,000
24	Tarifë parkimi	16,973,951	24,000,000	18,721,853	23,330,282	15,000,000
25	Tarifë shërbimi,	6,988,357	14,127,000	4,512,602	5,000,000	14,233,456



BASHKIA KORÇË


	vërtetime, çertifikata, regj. Biznesi e.t.j					
26	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	2,445,800	500,000	157,500	243,400	500,000
27	Miratim projekti	108,500	300,000	115,500	157,000	300,000
28	Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara	0	250,000	0	0	30,000
29	Shërbime zjarrfikëse në Bashki fqinje	0	300,000	0	0	1,348,250
30	Marrje me qera pylli+ qera per kullota	29,405,175	10,900,000	12,594,942	13,932,534	13,000,000
31	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit	2,488,686	5,000,000	3,755,676	3,937,876	5,000,000
32	Vërtetime transporti	90,000	100,000	105,000	114,000	50,000
33	Prodhimet e dyta medicinale	182,900	300,000	246,150	246,150	400,000
34	Shitje Dokumenta ankandi	1,000	1,000	1,000	1,000	2,000
35	Gjoha policia bashkiake	1,455,000	2,000,000	2,368,000	2,500,000	2,500,000
36	Gjoha për vonesë në pagesë	5,767,647	7,500,917	6,512,066	7,297,631	7,000,000
37	Gjoha inspektoriati i ndërtimit	750,000	3,600,000	2,010,000	2,100,000	2,500,000
38	Gjoha të drejtorisë së kontrollit të territorit	536,500	1,500,000	341,500	321,500	660,000
39	Gjoha të drejtorisë së te ardhurave	60,000	300,000	60,000	120,000	300,000
40	Qira objekti, Qera Trualli, Qera T.bujqësore	1,967,308	19,920,000	1,708,602	1,952,157	2,246,360
41	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	420,000	1,200,000	390,000	470,000	760,000
42	Tarife për leje ndërtimi	0	450,000	113,000	120,000	500,000
43	Tarifë servituti	1,041,376	2,000,000	486,544	653,146	1,000,000
44	Të ardhura nga qiratë, banesa sociale	6,946,843	6,962,400	6,354,908	6,962,400	7,080,000
45	Qira nga banesat në pronësi të Bashkisë Korçë, Enti Kombëtar i Banesave	3,040,643	5,377,573	3,055,972	3,372,212	3,585,200
46	Kamatë vonesa(qira objekti)	404,782	500,000	383,411	406,728	500,000
47	Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve	0.00	1,500,000	5,040	5,040	3,000



BASHKIA KORÇË

	nëntokësore					
48	Tarifë uji	231,521	450,000	100,341	137,621	350,000
	<b>TOTALI</b>	<b>562,091,525</b>	<b>961,670,057</b>	<b>575,544,426</b>	<b>635,220,650</b>	<b>977,910,766</b>

	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Të ardhura ndër vite</b>	<b>562,091,525</b>	<b>635,220,650</b>	<b>977,910,766</b>



**1. TAKSA MBI NDËRTESESËN**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksë mbi ndërtesën</b>	<b>103,192,896</b>	<b>104,365,881</b>	<b>140,000,000</b>

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2019 planifikohet të jetë në vlerën 140,000,000 lekë. Kjo taksë planifikohet të arkëtohet në vlerën 45,576,352.44 lekë prej 3,358 ndërtesash që shfrytëzohen nga



## BASHKIA KORÇË

subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, O.J.F apo njësi në pronësi të individëve të cilët nuk i kanë vënë në shfrytëzim në Bashkinë Korçë me një sipërfaqe prej 492,901.76 m<sup>2</sup> (369,687.35 m<sup>2</sup> në njësinë administrative Korçë konkretisht: 67,001.80 m<sup>2</sup> sipërfaqe për prodhim, 217,858.76 m<sup>2</sup> sipërfaqe për tregëti dhe shërbime, 84,826.79 m<sup>2</sup> sipërfaqe për magazina, bodrume, parkinge të mbuluara dhe ndërtesa të tjera si dhe nga 123,214.41 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë konkretisht: 47,348.30 m<sup>2</sup> sipërfaqe për prodhim, 71,678.81 m<sup>2</sup> sipërfaqe për tregëti dhe shërbime, 3,110.20m<sup>2</sup> sipërfaqe për blegtori 1,077.10 m<sup>2</sup> sipërfaqe për magazina, bodrume dhe ndërtesa të tjera).

Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 57,854,960.90 lekë prej 16,214 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 1,983,189 m<sup>2</sup> në njësinë administrative Korçë dhe 9,161 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 840,536 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë) si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet të arkëtohet në vlerën 36,504,870 lekë. Theksojmë këtu se ndikim në këtë planifikim kanë pasur lehtësitë fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë. Vetëm për vitin 2019 janë të përjashtuar 5,283 familje me njësi pronësore për banim me sipërfaqe totale 689,175 m<sup>2</sup> : konkretisht në njësinë administrative Korçë 4,302 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 571,455 m<sup>2</sup> dhe 981 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 117,720 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative me vlerë totale prej 14,781,488 lekë. Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha, do të vijojnë përkushtimin në rrugën e nisur për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit.

## 2. TAKSA MBI TRUALLIN

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Taksë Trualli	6,119,732	9,000,000	9,000,000

Taksa mbi truallin për vitin 2019 planifikohet të jetë në vlerën 9,000,000 lekë. Referuar regjistrimeve dhe verifikimeve të kryera ndër vite duke pasur si vit fillestar vitin 2016 nga i cili filloi të aplikohet taksa mbi truallin si për subjektet e biznesit të cilat dispononin këtë pasuri për efekt të zhvillimit të aktivitetit të tyre apo dhe nga poseiduesit familjarë na rezulton që deri më sot të kemi



## BASHKIA KORÇË

një ndryshim në rritje të regjistrimeve nga informacioni bazë si për numrin e poseiduesve të truallit që e përdorin për biznes apo dhe atyre poseiduesve familjarë që e përdorin truallin për banim ashtu dhe për sipërfaqet respektive të tyre.

Gjithashtu po vazhdon puna në terren për identifikim dhe inventarizim të sipërfaqeve të truallit që përdoret për banim. Taksa mbi truallin planifikohet të arkëtohet nga 352 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh me një sipërfaqe prej 445,556.4 m<sup>2</sup> të inventarizuara deri më tani në vlerën 8,020,015.2 lekë, nga 6,989 familje të Bashkisë Korçë me një sipërfaqe trualli për banim prej 989,897 m<sup>2</sup> të inventarizuara deri më tani në vlerën 415,756.7 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit të cilët parashikohen të arkëtohen gjatë vitit 2019 në vlerën 564,723.2 lekë. Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha, do të vijojnë përkushtimin në rrugën e nisur për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit.

### 3. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Taksa mbi tokën bujqësore	20,816,412	27,582,545	40,000,000

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2019 është planifikuar 40,000,000 lekë prej 11,301 pronarësh apo poseiduesish të saj me një sipërfaqe prej 12,217.16 ha, referuar këtu informacionit që ne disponojmë në lidhje me sipërfaqet e tokës bujqësore, kategorive të tyre si dhe duke përfshirë debitorët e krijuar të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë gjatë vitit 2018 dhe në vitet e mëparshme. Gjithashtu po vazhdon puna në terren për evidentim e saktë të debitorëve pasi një pjesë e madhe e personave që i kanë marrë këto toka në përdorim sipas ligjit rezultojnë të mos jetojnë në Bashkinë Korçë, por të jenë transferuar në qytete të tjera apo dhe jashtë vendit.

Gjithashtu problem rezulton dhe transferimi i familjeve nga njëra njësi në një njësi tjetër të Bashkisë Korçë pa kryer asnjë procedurë pranë zyrave të gjendjes civile.

Problem tjetër është dhe inventarizimi i numrit të pronarëve apo poseiduesve të tokës bujqësore si dhe sipërfaqeve faktike të tokës bujqësore që ata disponojnë pasi informacioni i transferuar pranë Bashkive mbas reformës territoriale me gjendjen faktike ka shumë ndryshime si në sipërfaqet



## BASHKIA KORÇË

aktuale të tokës bujqësore ashtu dhe në ndryshimet e emrave apo mbiemrave të pronarëve apo poseiduesve të cilët janë pajisur me A.M.T.P nga ish komunat por që këto ndryshime nuk janë pasqyruar në asnjë regjistër që dispononin ish komunat. Kjo taksë planifikohet të mblidhet për vitin 2019 nga 11,301 pronarë apo përdorues të tokës bujqësore për detyrimin vitit 2019 referuar sipërfaqes prej 12,217.16 ha për çdo kategori të përcaktuar si dhe nga pronarët apo përdoruesit e tokës bujqësore debitorë për vitet paraardhëse apo dhe ata që s' do mund ta paguajnë këtë taksë gjatë vitit 2018. Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, Drejtoria e të Ardhurave dhe njësitë administrative të Bashkisë Korçë, do të vijojnë përkushtimin në rrugën e nisur për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit.

#### 4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme</b>	<b>7,389,180</b>	<b>9,010,046</b>	<b>13,000,000</b>

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Planifikimi për vitin 2019 do të jetë 13,000,000 lekë, duke ju referuar parashikimit të bërë nga Z.V.R.P.P-Korçë e cila në rolin e agentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

#### 5. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor</b>	<b>24,619,201</b>	<b>36,490,736</b>	<b>42,000,000</b>

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2019 është planifikuar 42,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë e cila referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, në rolin e agentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën



## BASHKIA KORÇË

e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor. Ky parashikim është bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë bazuar në realizimin e viteve paraardhëse, ndryshimet e fundit ligjore si dhe në të dhënat e disponuara për periudhën Janar – Nëntor të vitit 2018.

### 6. TATIMI FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Tatimfitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	6,728,100	5,480,604	23,000,000

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2019 parashikohet të jetë 23,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë. Siç e kemi theksuar dhe më parë është një ndër taksat që është prekur ndjeshëm dhe shpesh nga ndryshimet në legjislacionin tatimor.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

Ky zë planifikohet të realizohet në këtë vlerë nga subjektet që i nënshtrohen pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga subjektet debitorë të cilët nuk do e paguajnë tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël deri në fund të vitit 2018.



BASHKIA KORÇË

**7.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	<b>59,137,584</b>	<b>60,000,000</b>	<b>240,000,000</b>

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2019 planifikohet në vlerën 240,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit referuar treguesve të viteve 2017 dhe 2018 dhe interpretimit ligjor të bërë në lidhje me këtë taksë nga ana e Ministrisë së Financave sipas së cilës banesat individuale të cilat kapnin një numër të konsiderueshëm të lejeve të ndërtimit duhet të llogariten me 3% të vlerës së investimit.

**8. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet</b>	<b>15,711,598</b>	<b>25,440,494</b>	<b>40,000,000</b>

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2019 është planifikuar 40,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit duke u nisur nga të dhënat e vitit 2018 të cilat reflektojnë një ritëm të lartë në lidhje me dhënien e lejeve të legalizimeve si dhe me rritje të nivelit të arkëtimeve krahasuar me periudhat paraardhëse.

**9. TAKSA E FJETJES NË HOTEL**

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Taksa e fjetjes në hotel</b>	<b>3,931,249</b>	<b>4,927,090</b>	<b>5,500,000</b>

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2019 i taksës së fjetjes në hotel është bërë duke u bazuar në numrin e njësive që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim si dhe kapacitet akomoduese të tyre. Kjo taksë për vitin 2019 planifikohet në vlerën 5,500,000 lekë.



## BASHKIA KORÇË

Aktualisht numërohen 27 bujtina dhe 58 hotele me kapacitet akomodues 2024 persona e krahasuar kjo me vitin paraardhëskemi një rritje prej 21 subjektsh akomoduese dhe me shtim kapaciteti prej 473 personash si dhe krahasuar me vitin 2017 numri i personave të akomoduar në këto struktura kap shifrën e 63,280 personash ose 12,554 persona të akomoduar më shumë për të njëjtën periudhë.

### 10. TAKSA E TABELËS

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Taksa e Tabelës	13,361,853	9,521,391	13,000,000

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

**Tabela për qëllime identifikimi**, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen.

**Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesitose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve .

**Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, përekspozime të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës për vitin 2019 është planifikuar 13,000,000 lekë, parashikim ky nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë reklamuese dhe sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë si dhe ato që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2019. Konkretisht kjo taksë planifikohet të arkëtohet nga subjektet që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2019, nga 1 subjekt që aktualisht ka vendosur tabelë të thjeshtë identifikuese mbi 10 m<sup>2</sup> me sipërfaqe totale prej 13 m<sup>2</sup> në vlerën 110,500 lekë, nga 7 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë të thjeshtë identifikuese mbi 2 m<sup>2</sup> me sipërfaqe totale prej 37.5 m<sup>2</sup> në vlerën 375,000 lekë, 34 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë



## BASHKIA KORÇË

identifikuese me ndriçim, me sipërfaqe totale prej 138.76 m<sup>2</sup> në vlerën 2,081,400 lekë, 65 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë për qëllime reklamimi me sipërfaqe totale prej 357.46 m<sup>2</sup> në vlerën 8,042,850 lekë dhe 14 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim në vlerën 1,680 lekë. Po gjatë vitit 2019 planifikohet të mblidhen detyrime debitore nga 3 subjekte të cilat nuk e kanë paguar taksën e tabelës për qëllime identifikimi brenda vitit 2018 në vlerën 142,300 lekë si dhe nga 10 subjekte të cilat nuk e kanë paguar taksën e tabelës për qëllime reklamimi brenda vitit 2018 në vlerën 1,717,700 lekë.

### 11. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11,624,815	2,000,000	16,000,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 16,000,000 lekë. Parashikim ky i bazuar në nivelin e investimeve që kjo ministri po kryen për përmirësimin e infrastrukturës në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike në vend.

### 12. DIVIDENTI NGA U.K.KO

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Dividenti nga U.K.KO	4,433,134	7,864,515	9,000,000

Dividenti nga U.K.KO për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë planifikim ky i kryer nga ndërmarja e U.K.KO.



BASHKIA KORÇË

### 13. DIVIDENTI NGA TREGU I SHUMICËS

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Dividenti nga Tregu i Shumicës	1,233,662	0	1,600,000

Dividenti nga Tregu i Shumicës për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 1,600,000 lekë planifikim ky i kryer nga administrata e Tregut të Shitjes me Shumicë të Fruta - Perimeve. Për vitin 2018 nuk do të ketë realizim të këtij zëri pasi dividenti i mbledhur nga viti 2017 do të kalojë për investime në Tregun me Shumicë të Fruta Perimeve.

### 14.RENTA MINERARE

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Renta minerare	74,247	126,535	200,000

Çdo person fizik apo juridik, që është i licensuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Taksa e rentës minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare.

Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore Për vitin 2019 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën 200,000 lekë.



BASHKIA KORÇË

**15. TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë regjistrimi për leje transporti</b>	<b>2,562,060</b>	<b>1,646,930</b>	<b>2,600,000</b>

Tarifë rregjistrimi për leje transporti për vitin 2019 është planifikuar 2,600,000 lekë planifikim ky i bërë nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit. Për këtë planifikim i është referuar ndryshimeve të fundit të legjislacionit aktual në fuqi në fushën e transportit, pasi një pjesë e mirë e liçencave për subjektet që operojnë në këtë fushë sipas udhëzimeve të Ministrit të Transportit janë dhënë me afat 1 vjeçar me qëllim përshtatjen sipas kërkesave të ligjit.

**16. TARIFË THERJE BAGËTIE**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë therje bagëtie</b>	<b>1,034,950</b>	<b>2,728,400</b>	<b>3,000,000</b>

Tarifë therje bagëtie për vitin 2019 është planifikuar 3,000,000 lekë, parashikim ky i Drejtorisë së Kontrollit Territorit i cili bazohet në realizimin e kësaj takse në vitet e mëparshme, realizimit të pritshëm për vitin 2018 si dhe në masat e mara për mbikqyrjen e sigurisë ushqimore, formalizimit të tregut, parandalimit të therjes së kafshëve në vende ilegale si dhe disiplinimin e therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë.

**17. TARIFË MUR PERIMETRAL**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë mur perimetral</b>	<b>570,146</b>	<b>650,000</b>	<b>1,500,000</b>

Tarifë mur perimetral për vitin 2019 është planifikuar 1,500,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.



BASHKIA KORÇË

**18. TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	3,529,420	812,400	862,500

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2019 është parashikuar 862,500 lekë, parashikim ky i Drejtorisë së Kontroll Territorit i cili bazohet në numrin subjekteve dhe detyrimet që ata kanë ndaj Bashkisë, të cilat nuk mundën të arkëtoheshin brenda vitit 2018 por që me vazhdimin e ndjekjessë procedurave ligjore nga ana jonë do të arkëtohen gjatë vitit 2019.

**19. TARIFA E PASTRIMIT**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Tarifa e Pastrimit	112,670,439	160,515,809	178,500,000

Tarifa e pastrimit për vitin 2019 planifikohet të jetë në vlerën 178,500,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 3,212 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,628 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 28,200,000 lekë , nga 584 subjekte të biznesit të madh në vlerën 34,000,000 lekë, nga 19,848 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 75,422,400 lekë, nga 7,589 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 11,302,500 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 29,413,100 lekë.

Kriteri bazë për vendosjen e tarifës së pastrimit është kostoja e këtij shërbimi, kosto e cila paguhet nga bizneset apo familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë shërbimin e pastrimit. Tarifa e pastrimit mbledhet nga dy struktura, Drejtoria e të Ardhurave në lidhje me tarifën e pastrimit për kategorinë e biznesit dhe për kategorinë familjarë nga U.K.KO.

**20. TARIFË NDRIÇIMI**

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
Tarifë Ndriçimi	36,266,541	39,744,693	43,500,000



## BASHKIA KORÇË

Tarifë ndriçimi për vitin 2019 planifikohet të jetë në vlerën 43,500,000lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 3,212 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,628 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 11,285,000 lekë, nga 584 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,480,000 lekë, nga 19,848 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 13,893,600 lekë, nga 7,589 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 3,774,250 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 9,026,650 lekë.

Kriteri bazë për vendosjen e tarifës së ndriçimit publik është kostoja e këtij shërbimi, kosto e cila paguhet nga bizneset apo familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë shërbimin e ndriçimit publik. Tarifa e ndriçimit mblidhet nga dy struktura, Drejtoria e të Ardhurave në lidhje me tarifën e ndriçimit për kategorinë e biznesit dhe për kategorinë familjarë nga U.K.KO.

### 21. TARIFË GJELBËRIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë Gjellbërimi</b>	<b>23,683,772</b>	<b>25,000,000</b>	<b>31,000,000</b>

Tarifa e gjellbërimit për vitin 2019 planifikohet të jetë në vlerën 31,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 2,861 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,277 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 9,020,500 lekë, nga 584 subjekte të biznesit të madh në vlerën 3,847,500 lekë, nga 19,848 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 9,924,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 8,208,500 lekë.

Kriteri bazë për vendosjen e tarifës së gjellbërimit është kostoja e këtij shërbimi, kosto e cila paguhet nga bizneset apo familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë shërbimin e gjellbërimit. Tarifa e gjellbërimit mblidhet nga dy struktura, Drejtoria e të Ardhurave në lidhje me tarifën e gjellbërimit për kategorinë e biznesit dhe për kategorinë familjarë nga U.K.KO.



## BASHKIA KORÇË

### 22. TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë mirëmbajtje varreza publike</b>	<b>12,908,387</b>	<b>13,931,905</b>	<b>18,000,000</b>

Tarifë mirëmbajtje varreza publike për vitin 2019 është planifikuar 18,000,000. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 19,848 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 9,924,000 lekë, nga 7,508 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 3,754,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë parashikohet në vlerën 4,322,000 lekë. Kriteri bazë për vendosjen tarifës për mirëmbajtje varreza publike është kostoja e këtij shërbimi, kosto e cila paguhet nga familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike mbledhet nga dy struktura, nga Drejtoria e të Ardhurave dhe U.K.KO në lidhje me tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike për kategorinë familjarë.

### 23. TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2017	2018 (i pritshëm)	2019
<b>Tarifë për zënien e hapësirave publike</b>	<b>9,184,159</b>	<b>15,000,000</b>	<b>27,800,000</b>

- shpenzime personeli në vlerën 26,650 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 5,442 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 2,178 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga do të jetë në vlerën 22,800 mijë lekë.



## BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 3,850 mijë lekë.

Shpenzimet operative për këtë program janë parashikuar në vlerën 2,442 mijë lekë Planifikimi i këtyre shpenzimeve është bërë duke u bazuar në planin e buxhetit 2018 si dhe në realizimin 11 mujor të shpenzimeve.

### Detajimi i shpenzimeve operative MZSH (vlerat në 000/lekë)

	Emërtimi	MNZSH							
		2016	2017	Pl. 2018	Fakt 11 mujor	Real I Pl.te pritshem	Pl 2019	Pl.2019-Pl.2018	Pl.2019- Pl. pritsëm
1	Kancelari e leter			25	17	25	25	-	-
2	Materiale elektrike			35	35	35	15	(20)	(20)
3	Materiale ngrohje (dru zjarri)		122	300	180	300	290	(10)	(10)
4	Bloqe administrative letra me vlerë	15	4	30	28	30	20	(10)	(10)
5	Energji elektrike	356	406	500	89	500	340	(160)	(160)
6	Materiale promocionale						14	14	14
7	Shpenzime uji	131	173	250	121	250	200	(50)	(50)
8	Karburant	880	794	900	520	900	790	(110)	(110)
9	Riparim paisje makinash		143	210	202	210	363	153	153
10	Shpenzime mirembajtje transporti						35	35	35
11	Siguracion mjetesht transporti	32	73	290	65	290	100	(190)	(190)
12	Interneti+telefon		37	39	19	39	30	(9)	(9)
13	TVMP dhe SGS			315	38	315	140	(175)	(175)
14	Dieta	6	4	25	0	25	30	5	5
15	Meremetim tavani kapanoni I automjeteve		214						
16	Leter shkrimi fotokopimi		21						
17	Vaj filtra		25	30	0	30		(30)	(30)
18	Materiale pastrimi	21	21	40	16	40	35	(5)	(5)
19	Shpenzime te tjera						15	15	15
20	Boje printeri e fotokopjuesi			50	0	50		(50)	(50)
21	Telefon			30	0	30		(30)	(30)



## BASHKIA KORÇË

22	Vendime gjyqësore		100	0	100		(100)	(100)
	<b>Total Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi</b>	<b>1,441</b>	<b>2,037</b>	<b>3,169</b>	<b>1,530</b>	<b>3,169</b>	<b>2,442</b>	<b>(727)</b>

Në buxhetin e këtij programi janë dhe emergjencat civile, të cilat për vitin 2019 janë planifikuar në vlerën 3,000 mijë lekë.

Ky fond është parashikuar të përdoret për parandalimin dhe përbalimin e emergjencave civile, duke përfshirë edhe dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilëve dëmtohen nga fatkeqësi të ndryshme, në zbatim të ligjit 8756 dt. 26.03.2002 “Për emergjencat civile” neni 16, pika 2, gërma ç).

### Shpenzime për investime

Të ardhurat që do të realizohen gjatë vitit 2019 nga ky shërbim do të jenë në vlerën 2,178 mijë lekë dhe do të përdoren për investime. Detajimi i investimeve do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

## 7.5. Çështjet e përgjithshme ekonomike tregëtare dhe të punës 041

### Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik 04130

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.**

### Njësia shpenzuese: Bashkia

Në këtë program përfshihet mbështetja dhe promovimi i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore. Buxheti i planifikuar për programin mbështetja për zhvillimin ekonomik është 13,232 mijë lekë si më poshtë:

-shpenzime korrente 13,232 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 9,700 mijë lekë. Detajimi i shpenzimeve operative jepet si më poshtë:

000/lekë

	Emërtimi	Plan 2019
1	Blerje karburanti (gaz) për Markatën e shijes	6000
2	Materiale konsumi për Markatën e shijes	50
3	Energjia elektrike për Markatën e shijes	1500



## BASHKIA KORÇË

4	Pagesa e ujit për Markatën e shijes	350
5	Aktivite Markata e shijes 5 herë	1500
6	Dekor për Markatën e shijes	200
7	Honorare për Markatën e shijes	100
	<b>Total Shpenzime operative mbështetja për zhvillimin ekonomik</b>	<b>9,700</b>

Fondi i planifikuar në zërin transferta tek organizatat do të jetë 3,532 mijë lekë si më poshtë:

000/lekë

	Emërtimi	Bashkia					
		2016	2017	Pl. 2018	Fakt 11 mujor	Pl. i pritshem	Pl 2019
1	Transfertë për shoqatën BID	2,116	2,105	2,500	2,495	2,500	2,607
2	Transfertë për shoqatën TID			446	376	446	925
	<b>Total</b>	<b>2,116</b>	<b>2,105</b>	<b>2,946</b>	<b>2,871</b>	<b>2,946</b>	<b>3,532</b>

### 7.6. Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia 042

**Programi: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve 04220**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**

Në këtë program përfshihet administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të grandeve për bujqësinë e zhvillimit rural, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit. Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të grandeve për bujqësinë e zhvillimit rural. Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit.

Buxheti i planifikuar për këtë program është në vlerën 5,085 mijë lekë dhe nurmi i punonjësve është 8, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 4,957 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 128 mijë lekë



## BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për paga për këtë program është në vlerën 4,248 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore është në vlerën 709 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzimeve operative është në vlerën 128 mijë lekëjepet si më poshtë:

	Emërtimi	Plan 2019
1	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52
2	Udhetime dhe dieta	50
3	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	26
	Total Shpenzime operativeprogrami shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	128

### 7.7. Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia 042

#### Programi: Administrimi i pyjeve dhe kullotave 04260

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.**

#### Njësia shpenzuese: Bashkia

Në këtë program përfshihen fondet nga funksioni i transferuar që nga viti 2016 i administrimit të pyjeve. Ky funksion merret me administrimin e çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, mbikqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore dhe dhënia e licensave për prerje pemësh. Gjithashtu ky shërbim merret me shpërndarjen e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes. Buxheti i këtij program është në vlerën 28,266 mijë lekë dhe nr. i punonjësve 19, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 11,505 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 2,309 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 14,452 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për këtë program për vitin 2019 është në vlerën 9,859 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2018 ka një ulje 322 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për këtë program për vitin 2019 është në vlerën 1,646 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2018 ka një ulje 41 mijë lekë.



## BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për vitin 2019 është në vlerën 2,309 mijë lekë dhe krahasuar me planin e viti 2018 ka një rritje prej 1,939 mijë lekësh.

### Detajimi i shpenzimeve operative (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	Administrimi i pyjeve							
	2016	2017	Pl. 2018	Fakt 11 mujor	Pl. i pritshëm	Pl 2019	Pl.2019-Pl.2018	Pl.2019-Pl. pritshëm
1 Dieta	19	34	50	50	50	200	150	150
2 Blloqe adm (vert. te trans. per levizjen e lendes drusore)	185		150	0	150	168	18	18
3 Karburant		86	170	108	170	900	730	730
4 Riparim automjeti						300	300	300
5 Riparim dhe meremetim i stacionit te pyjeve Vithkuq						741	741	741
<b>Total Administrimi i pyjeve</b>	<b>204</b>	<b>120</b>	<b>370</b>	<b>158</b>	<b>370</b>	<b>2,309</b>	<b>1,939</b>	<b>1,939</b>

Të ardhurat që do të realizohen gjatë vitit 2019 nga ky shërbim do të jenë në vlerën 2,178 mijë lekë dhe do të përdoren për investime. Detajimi i investimeve do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

### 7.8. Transporti 045

#### Programi: Rrjeti rrugor rural 04520

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.**

#### Njësia shpenzuese: Bashkia

Në këtë program përfshihet ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.



## BASHKIA KORÇË

Buxheti i këtij program është në vlerën 200,000 mijë lekë dhe do të përdoret për investime. Detajimi i këtij fondi do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

### 7.9. Transporti 045

#### Programi:Transporti publik 04570

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.**

#### Njësia shpenzuese: Bashkia

Buxheti i këtij program është në vlerën 13,314 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime për personeli në vlerën 593 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 12,721 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga për supervizorin e transportit publik urban është 508 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për supervizorin e transportit publik urban është 85 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për transportin publik urban është 196 mijë lekë.

Detajimi i shpenzimeve operative jepet si më poshtë:

000/lekë

	Emërtimi	PI 2019
1	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52
2	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	50
3	Materiale konsumi	14
4	Riparim fotokopje dhe pajisje te ndryshme	30
5	Boje printeri e fotokopjues	50
	<b>Total Shpenzime operative program transporti public</b>	<b>196</b>

Fondi i planifikuar për subvencionin e shërbimit të transportit qytetës.

Ky shërbim kryhet nga shoqëria “**Ortakëria Korca**”sh.p.k e cila subvencionohet duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri.Në buxhetin e vitit 2019 ky shërbim planifikohet në vlerën **10.000 mijë lekë**. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm:

#### 1. Itenerari i përcaktuar në kontratë i mjeteve.



## BASHKIA KORÇË

**a)Linja Bankë:** Në lindje të rrethrotullimit të varrezave publike,kryqëzimi i rrugëve “Kristaq Sotiri”-“Asim Vokshi”,kryqëzimi i rrugëve “Sotir Polena”, “Asim Vokshi”,Birra Korça,Spitali,në busti Naum Veqilarxhi, përballë poliklinikës, pazari, BKT, Lëndina e lotëve, Universiteti, Parku, Sigurimet Shoqerore, UKKO ,përballë DPM, nënstationi, përballë kryqëzimit të rrugës “Pano Xhamballo”, me unazën, City Center, pazari, poliklinika, posta 1, shkolla”Demokracia”.

**b)Linja Unazë:** Nisja në lindje të rrethrotullimit të varrezave publike, kryqëzimi i rrugëve “Kristaq Sotiri”-“Asim Vokshi”, kryqëzimi i rrugëve “Sotir Polena”, “Asim Vokshi”, Birra Korça, Spitali, në busti Naum Veqilarxhi, përballë poliklinikës, pazari, City Center, Kryqëzimi Rr”Pano Xhamballo”, Shkolla e Maltës, parku, Sigurimet Shoqërore, UKKO, përballë DPM, Rr”Niko Kovaçi”, lëndina e lotëve, stacioni Bul.GJ.Kastrioti, pazari, Poliklinika, Posta 1, Shkolla “Demokracia”.

**c)Linja Medrese-SMT:** Nisja Shkolla “Demokracia” ish Formula 1, Medrese, Dyqanet e Gurta, Pazari, City Center, Fabrika “Tona Co”, stacioni Çiflik (me orar të reduktuar), ish frigoriferi, përballë City Center, Pazar, përballë Dyqaneve të Gurta, përballë Medresesë, pranë kryqëzimit me rr.”10 Korriku”.

**d)Linja Korçë-Dishnicë-Neviçisht-Kuç:** Nisja Tregu Maqedonas-Unazë, Rr e Barçit, Dogana, Dishnicë(qëndër), Neviçisht(hyrje), Belorta(hyrje), Kuç(hyrje), Belorta, Dogana, Tregu Maqedonas.

### Orari i shërbimit të këtij transporti.

**a)Linja Bankë,** orari 06:00-20:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-18:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

**b)Linja Unazë,** orari 06:00-20:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-18:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

**c)Linja Medrese-SMT,** orari 06:00-20:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-18:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

**d)Linja Korçë-Dishnicë-Neviçisht-Kuç ,** orari 07:00-15:00 gjatë gjithë vitit

### 1. Numri i mjeteve në linjë.

Në linjën Bankë 2 mjete

Në linjën Unazë 2 mjete

Në linjën Medrese-SMT 2 mjete

Në linjën Korçë-Dishnicë 1 mjet

### 2. Frekuenca



## BASHKIA KORÇË

Linja Banke-frekuenca çdo 22 minuta

Linja Unaze-frekuenca çdo 23 minuta

Linja Medrese-frekuenca çdo 20 minuta

Linja Korçe- Dishnice –frekuenca çdo 1 orë

### **3. Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara.**

Subjekti “Ortakëria” zbaton dhe pikën 12 të nenit 7 të kontratës mbi udhëtimin falas të moshës së tretë dhe me gjysëm çmimi të biletës për studentët.

- Në zërin transfera tek organizatat është planifikuar dhe kontributi i Bashkisë për mirëmbajtjen e sistemit rrugor "transporti inteligjent" në vlerën 2,525 mijë lekë.

### **7.10. Industri të tjera 047**

#### **Programi: Zhvillimi i turizmit 04760**

**Burimi i financimit: Transfera e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.**

#### **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Ky program merret me nxitjen e projekteve zhvillimore që kanë për qëllim rritjen ekonomike e turizmin në njësinë e vetëqëverisjes vendore, si dhe zhvillimin dhe promovimin e turizmit.

Buxheti i planifikuar për vitin 2019 është në vlerën 12,122 mijë lekë dhe nr i punonjësve është 5, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerë 3,042 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerë 9,080 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 2,607 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore është në vlerën 435 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për realizimin e projekteve për zhvillimin e turizmit është në vlerën 9,080 mijë lekë, e detajuar si më poshtë:

000/lekë

**Emërtimi**

**Plan 2019**



## BASHKIA KORÇË

1	Telekom+posta	111
2	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52
3	Energjia elektrike	270
4	Pagese uji	80
5	Udhetime dhe dieta	91
6	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	52
7	Riparim fotokopje dhe pajisje te ndryshme	50
8	Boje printeri e fotokopjues	49
9	Sherbime te printimit & publikimit	1,246
10	Shpenzime pritje-percjellje	1,005
11	Shpenzime qeramarrje te tjera	3,500
12	Shpenzime qeramarrje aparate dhe pajisje	1,600
13	Shpenzime transporti	424
14	Shpenzime te tjera	150
15	Shpenzime honorare	400
	<b>Total Shp. Operative +Projektet program zhvillimi i turizmit</b>	<b>9,080</b>

### Detajimi i projekteve

#### Titulli i projektit: Festa e Birrës

Data: 14-18 Gusht 2019

#### Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festa e birrës do të zhvillohet në datat 14-18 gusht 2019 në dy zona; tek fusha pranë stadiumit “Skënderbeu” dhe tek Pazari i vjetër . Një nga festat më të rëndësishme të qytetit, e cila tashmë është kthyer tashmë në traditë. Promovimi i vlerave të kulinarisë, traditës dhe zakoneve të qytetit të Korçës, nën tingujt e muzikës më të mirë shqiptare gjatë pesë netëve. Një dekor i personalizuar tek te dyja vendet do të krijojë një atmosferë shumë të bukur festive, duke rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve në qytet si dhe ndikuar pozitivisht në rritjen e zhvillimit ekonomik, social kulturore.

#### Qëllimi:

Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .

#### Rezultatet:

- Festa e birrës si një nga festat kryesore të qytetit do të krijojë një atmosferë festive në qytetin e Korçës për gjatë pesë netëve verore, duke tërhequr turistë brenda dhe jashtë vendit, duke e kthyer qytetin e Korçës në një pikë atraktive për turistët.
- Impakt direkt dhe indirekt në rritjen të ardhurave të bizneseve të rajonit.



## BASHKIA KORÇË

**Kostoja totale:** 2,850,000 Lek

### Festat lokale 2019

**Kohëzgjatja:** Gjatë vitit 2019

### Përshkrim i shkurtër

Tashmë “Korca, Qyteti i Festave” nuk është thjesht një slogan, por një realitet i prekshëm dhe një profil i konsoliduar i qytetit juglindor. Si qyteti i kulturës, arsimit, serenatave, karnavaleve dhe festave, Korca mirëpret të gjithë ata që e duan natyrën e bukur, artin, argëtimin pa fund dhe traditën. Bashkia e qytetit të Korçës ka hartuar disa projekte, me qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjimimin dhe promovimin e vlerave të qytetit, duke e bërë atë sa më atraktiv për turistët vendas dhe të huaj. Risi e këtij vitit është organizimi i një feste në çdo fshat duke promovuar vlerat e trashëguara kulturore të secilës krahinë, duke i kthyer këto zona në atraksione turistike të qytetarëve vendas dhe të huaj. Do të organizohen 11 festa në fshatrat Voskopojë, Drenovë, Dardhë, Vithkuq, Polenë, etj nëpërmjet të cilave do të promovohet tradita, vlerat artizanale dhe kulinaria.

### Qëllimi:

- Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj
- Promovim i traditës dhe vlerave artizanale të çdo fshati
- Kthimi i këtyre fshatrave në atraksione turistike

### Rezultatet:

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i produkteve të Rajonit
- Promovim i vlerave folklorike dhe kulturore

	<b>Festa</b>	<b>Datë</b>	<b>Kosto ( në Lekë)</b>
Voskopojë	<i>Festa e Voskopojës</i>	24 Qershor	485,500
Drenovë	<i>Festa e Drenovës</i>	21 Maj	405,500
Boboshticë	<i>Festa e Rakisë</i>	15 gusht	453,000
Dardhë	<i>Festa e Dardhës</i>	16 gusht	407,500



## BASHKIA KORÇË

Mborje	<i>Festa e Mborjes</i>	30 Qershor	352,500
Vithkuq	<i>Festa e Vithkuqit</i>	29 Qershor	409,500
Dvoran	<i>Festa e Mollës</i>	Tetor	492,500
Kamenicë	<i>Festa e Kamenicës</i>	6 maj	374,500
Turan	<i>Festa e Turanit</i>	22 Mars	352,000
Çilfig	<i>Festa e Çifligut</i>	Prill	360,500
Polenë	<i>Festa e Lakrorit</i>	Fund korriku – fillim gushti	492,500
Total			<b>4,585,500</b>

### Titulli i Projektit : Festivali i vjeshtës

### Kohëzgjatja : Shtator -tetor 2019

### Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Festivali i vjeshtës do të konsistojë në një numër të madh aktivitetesh që do të ndodhin gjatë kësaj periudhe në këtë qytet. Gjatë periudhës shtator - tetor do të ketë mjaft aktivitete kulturore, artistike dhe tradicionale për të përçuar vlerat që ky qytet mbart si dhe për të përçuar mesazhin së në Korçë festohet gjatë gjithë vitit. Bukuria e vjeshtës do të shoqërohet dhe me tingujt e muzikës shqiptare ku këngëtare të mirënjohur do të përformojnë tek skenat e Pazarit të vjetër dhe Zonës Këmbësore. Vençantia e këtij festivali do të jetë dhe dekori specifik dhe i personalizuar i realizuar me mjeshtëri nga stafi i bashkisë.

Do të publikohet një kalendar aktivitetesh i dedikuar këtij projekti i cili do të shpërndahet kudo për të tërhequr një numër të madh vizitorësh.

### Qëllimi:

- Vazhdimësia e këtij eventi krahas eventeve të shumta të qytetit, i cili synohet të kthehet në traditë të përvitshme.
- Kthimi i aktivitetit në një atraksion turistik
- Pasurimi i jetës social kulturore të qytetarëve të Korçës

### Rezultatet:

- Gjallërimi i jetës kulturore artistike në qytet
- Rritja e numrit të vizitorëve



## BASHKIA KORÇË

- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (Bare, restorante, hotele etj)
- Rritja e numrit të të rinjve si frekuentues të aktiviteteve të organizuara nga bashkia

**Kostoja totale:** 290,500 lekë

**Titulli i projektit :** “Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare”

### **Përshkrim i përgjithshëm i projektit:**

Bashkia Korçë gjatë vitit 2019 merr pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të organizohen nga institucione publike dhe private në Shqipëri ose jashtë saj dhe kanë në fokus promovimin e vlerave turistike të vendeve pjesëmarrëse. Pjesëmarrja e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla, rrit numrin e vizitorëve dhe investitorëve, si edhe krijon kontakte me investitorë të huaj, agjensi turistike etj, me të cilët Bashkia Korçë bashkëpunon në të ardhmen.

**Qëllimi:** Promovimi i vlerave turistike dhe agroturistike të Korçës, të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal të zonës.

### **Objektivat:**

- 1.Zhvillimin e mëtejshem të partneritetit publiko-privat, me synim përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe nxitjen e investimeve në qytet me fokus turizmin
2. Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.
- 3.Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e turizmit në qytetin e Korçës.

### **Rezultatet:**

1. Prezantimi i qytetit të Korçës si një destinacion turistik.
2. Nxitja e investimeve në qytet dhe rritja e mundësisë për të investuar në Korçë.
3. Prezantimi i ideve të bashkisë Korçë për zhvillimin e partneritetit publiko-privat.
4. Tërheqja e investitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj

**Kostoja totale:** 600,000 Lekë

## **7.11.Fondi rezervë 04910**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**



## BASHKIA KORÇË

Për vitin 2019 fondi i planifikuar është në vlerën 2,000 mijë lekë.

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi rezervë është fondi që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.

### **7.12. Fondi i kontigjencës 04940**

#### **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Për vitin 2019 fondi i planifikuar është në vlerën 1,000 mijë lekë.

Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

### **7.13. Menaxhimi i mbetjeve 051**

#### **Programi: Menaxhimi imbetjeve 05100**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

#### **Njësia shpenzuese: Bashkia**

Buxheti i këtij program është në vlerën 117,789 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 630 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 117,159 mijë lekë
- Fondi i planifikuar për paga për supervizorin e pastrimit është 540 mijë lekë.



## BASHKIA KORÇË

- Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për supervisorin e pastrimit është 90 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për shërbime pastrimit të qytetit në vlerën 79,618 mijë lekë.

Shërbimi i pastrimit është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në komunitet. Ky shërbim kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit dhe për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të fshatrave.

Në buxhetin e vitit 2019 sipas vlerës së kontratës kërkohet shuma **79,618 mijë lekë**. Objekti i këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagia e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve si dhe grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve të fshatrave. Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 502.865 m<sup>2</sup> rrugë dhe trotuare dhe fshihen me fshesë mekanike 171.290m<sup>2</sup> në ditë.

Transporti i mbeturinave për në landfill bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 nëpër lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë do evadohen rreth 85 ton mbeturina duke përfshirë qytetin edhe fshatrat. Nga projekti pilot për riciklimin që marrim në qese të vecanta letrën, plastikën, qelqin dhe aluminin që është filluar në pesë lagje të qyteti kemi arritur të reduktojmë sasinë e mbetjeve.

Kontrata e re parashikon që projekti të jetë i shtrirë në të gjithë Bashkinë e Korçës. Për këtë arsye do vendosen 100 kazanë jeshilë në qytet dhe 50 nëpër fshatra me qëllim reduktimin e mbetjeve, e cila përkthehet në kursim të shpenzimeve.

Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 cdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 188,208. m<sup>2</sup> si dhe larje speciale e rrugëve me sip. 67,508 m<sup>2</sup> çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 450 konteniere nëqytet cdo ditë dhe 150 konteniere në fshat që do të evadohen tre herë në javë. Mbetjet çohen në landfillin sanitar rajonal të Maliqit i cili kërkon kosto shtesë prej 37,541 mijë lekë për funksionimin e landfillit.

Pra fondi i planifikuar tek transfertat për organizatat është 37,541 mijë lekë, i cili është kontribut i Bashkisë Korçë për KRËM (pagesa fikse si aksioner i KRWM sha dhe pagesa mujore sipas faturave për mbetjet).



## BASHKIA KORÇË

### 7.14. Mbrojtja e mjedisit 056

#### Programi: Ndërgjegjësimi mjedisor 05630

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**

Programi mbulon veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.

Buxheti i planifikuar për këtë program është në vlerën 1,264 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 1.

- shpenzime personeli në vlerën 878 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 386 mijë lekë
  
- Fondi i planifikuar për paga për vitin 2019 është 752 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2019 është 126 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për shpenzime operative për vitin 2019 në vlerën 386 mijë lekë.

Ky fond do të përdoret për realizimin e projekteve në fushën e mjedisit të detajuara si më poshtë:

000/lekë

	Emertimi	Plan 2019
1	Sherbime te printimit & publikimit	72
2	Shpenzime pritje-percjellje	35
3	Shpenzime te tjera	64
4	Shpenzime udhetim i brendshem	140
5	Shpenzime honorare	75
	<b>Totali shp operative ndërgjegjësimi mjedisor</b>	<b>386</b>

**Detajimi i projekteve**

**Titulli i projektit: Dita Ndërkombëtare e Tokës**

**Data: 22 Prill 2019**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**



## BASHKIA KORÇË

Data 22 prill, njihet në gjithë botën, si Dita Ndërkombëtare e Tokës. Kjo është një ditë që shërben për të dhënë alarmin për dëmet që njerëzimi i shkakton pyjeve, lumenjve, tokës dhe pasurive të tjera të natyrës dhe të reflektoj e sensibilizohet për të ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të saj. Më 22 prill, në mbarë botën, dashamirës të mjedisit organizojnë një varg aktivitetesh për të mirën e mjedisit dhe të njeriut, si: aktivitete pastrimi, gjelbërimi, pyllëzimi, manifestime në formë protestash, ekspozita, koncerte, vizita, peticione, orë edukative me nxënës, konferenca shkencore lidhur me problemet mjedisore etj.

### **Qëllimi:**

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë është angazhuar të kryejë një sërë aktivitetesh, me qëllim sensibilizim qytetar.

### **Rezultate:**

- Sensibilizim qytetar
- Ndërgjigjesim mbi ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit
- Angazhim i qytetarëve lidhur me dobinë e mjedisit
- Angazhim dhe sensibilizim të nxënësve të shkollave.

**Kostoja totale: 64,000 Lekë**

### **Titulli i projektit: Dita pa makina**

**Data: 22 shtator 2019**

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Dita Ndërkombëtare pa Makina, synon sensibilizimin e njerëzve që të shmangin të paktën një ditë makinat e tyre, të cilat emetojnë lëndë të dëmshme për organizimin dhe si përpjekje për të kontribuar në mbrojtje të mjedisit.

Dita pa makina organizohet në qytete të ndryshme në vende të ndryshme të botës në mënyra të ndryshme, por me qëllimin e përbashkët për të reduktuar numrin e automjeteve në qytet. Përfitimi i madh shoqëror është një ditë me sa më pak trafik, një ambient më të gjelbër dhe reduktim të varësisë nga karburanti. Sot dita pa makina përfshin përkrahje nga 1500 qytete në 40 vende të botës.

Në qytetin e Korçës do të organizohet një garë çiklistike kombëtare për të sensibilizuar qytetarët në Ditën pa Makina.

### **Qëllimi:**



## BASHKIA KORÇË

-Synojmë sensibilizimin e çdo qytetari, institucioni publik apo privat për të ndërmarrë veprime në mbrojtje të mjedisit.

### **Rezultate:**

- Të shmangim makinat duke përdorur më shumë biçikletat dhe duke bërë ecje në këmbë aty ku mundemi.

- Në këtë ditë synojmë të jemi sa më miqësor me mjedisin

**Kostoja totale: 322,000 Lekë**

### **7.15.Urbanistika 061**

**Programi: Planifikimi urban vendor 06140**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia Korçë**

Ky program përfshin zhvillimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të zhvillimit urbanistik. Lëshimin e lejeve për ndërtime të reja, zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Planifikim i përgjithshëm, duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e Planeve të Përgjithshme Vendore/Planeve të Zhvillimit Strategjik si dhe hartimin e planeve të zonimit dhe të rregullave të ndërtimit.

Buxheti i këtij program është në vlerën 39,114 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 13, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 9,649 mijë lekë
  - shpenzime korrente në vlerën 2,665 mijë lekë
  - shpenzime për hartim projektesh dhe oponenca teknike në vlerën 6,800 mijë lekë
  - shpenzime për investimenë vlerën 20,000 mijë lekë
- 
- Fondi i planifikuar për paga për këtë program është 8,268 mijë lekë.
  - Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është 1,381 mijë lekë.
  - Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 2,665 mijë lekë të detajuara si më poshtë:



## BASHKIA KORÇË

000/lekë

	Emërtimi	Plan 2019
1	Telekom+posta	116
2	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52
3	Energjia elektrike Bashki	612
4	Pagese uji	65
5	Udhetime dhe dieta	235
6	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	88
7	Materiale konsumi	27
8	Riparim fotokopje dhe pajisje te ndryshme	70
9	Boje printeri e fotokopjues	100
10	Aplikim ne Ministrine e Mjedisit per miratim VNM	300
11	Mirembajtje e "Platformes ËEB GIS"	1,000
	<b>Total Shpenzime operative (program planifikimi urban vendor)</b>	<b>2,665</b>

- Fondi i planifikuar për hartim projektesh dhe oponenca teknike është në vlerën 6,800 mijë lekë. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për vitin 2019 është 20,000 mijë lekë.

Detajimi i këtyre fondeve do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

### 7.16. Zhvillimi i komunitetit 062

**Programi: Shërbime publike vendore 06260**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia Korçë**

Ky program përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.

Buxheti i planifikuar për këtë program për vitin 2019 është në vlerën 4,812 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 1, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 519 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,293 mijë lekë



## BASHKIA KORÇË

- Fondi i planifikuar për paga për mbikqyrësin e shërbimit të Mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 445 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për mbikqyrësin e shërbimit të Mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 74 mijë lekë.
- Fondi i planifikuar për shërbimin e Mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 4,293 mijë lekë sipas kontratës.

Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:

- a. Pastrim parcelash , rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative
- c. Mbjellje drurë dekorative
- d. Kositje , grumbullim dhe transport bari
- e. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- f. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- g. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- h. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- j. Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve

### **7.17. Shërbimet rekreative dhe sportive 081**

#### **Programi: Sport dhe argëtim 08130**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese Bashkia Korçë**

Me VKB nr 127 datë 09.11.2018 “Për mbylljen e institucionit të varësisë Klubi i Futbollit Skënderbeu”, institucioni mbyll veprimtarinë ekonomiko – financiare. Për këtë arsye fondet për pagat, sigurimet shëndetsore dhe shoqërore dhe shpenzime operative (ujë, energji, telefon) do të shlyen nga Bashkia Korçë në vitin 2019.

Buxheti i këtij program është në vlerën 54,406 mijë lekë i detajuar si më poshtë:



## BASHKIA KORÇË

- shpenzime personeli në vlerën 450 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 53,956 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga të muajit dhjetor 2018 të ish Klubit të Futbollit është në vlerën 398 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë muajit dhjetor 2018 të ish Klubit të Futbollit është në vlerën 52 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative të muajit dhjetor 2018 të ish Klubit të Futbollit është në vlerën 173 mijë lekë, e cila do të përdoret për shlyerjen e shpenzimeve si më poshtë:

Shpenzime ujë 50 mijë lekë

Shpenzime telefonike 3 “”

Energjia elektrike 120 “”

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për realizimin e projekteve në këtë program është në vlerën 783 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

000/lekë

	Emërtimi	PI 2019
1	Sherbime të printimit & publikimit	7
2	Shpenzime qeramarje aparate dhe pajisje	25
3	Shpenzime të tjera	106
4	Shpenzime udhëtim I brendshëm	360
5	Shpenzime honorare	285
	<b>Totali I shp operative sport dhe argëtim</b>	<b>783</b>



## BASHKIA KORÇË

### **Detajimi i projekteve:**

**Titulli i projektit: Korça open air**

**Kohëzgjatja: Fund dhjetori**

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Bashkia Korçë do të organizojë gjatë muajit Dhjetor 2019 aktivitetin e përvitshëm “Korça Open Air”, në të cilën do të marrin pjesë parashutistë profesionistë nga Aeronautika Shqiptare, që do të garojnë mes tyre duke organizuar fluturime të lira në qytetin e Korçës. Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve në natyrë, do të zhvillohen fluturime dyshe me ndihmën e profesionistëve. Në përmbyllje të aktivitetit do të realizohet Ceremonia zyrtare e ndarjes së çmimeve për fituesit e aktivitetit “Korça Open Air 2019” .

**Qëllimi:** Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktiviteteve sportive në natyrë.

### **Objektivat:**

1. Zhvillimi i aktiviteteve në natyrë me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e turizmit të aventurës.
2. Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar pas turizmit të aventurës.

### **Rezultatet:**

1. Realizimi i fluturimeve të lira nga ajri për të gjithë qytetarët, vizitorët vendas dhe të huaj.
2. Nxitja e brezit të rinj për të frekuentuar aktivitetet që zhvillohen në natyrë.

**Kostoja totale : 360, 000 Lekë**

**Titulli i projektit:** Akademia verore e modës

Bashkia Korçë do të organizojë gjatë vitit 2019 Akademinë Verore të Modës, e cila ka për qëllim ofrimin e mundësisë për një formim profesional të nxënësve që kanë pasion tregun e modes.

Trajnimi i nxënësve do të realizohet nga profesionistë të kualifikuar, të cilët njohin dinamikën e tregut dhe ofrojnë mundësinë e një formimi të kompletuar për të rinjtë. Aktiviteti do të ketë një kohëzgjatje 3 mujore dhe në këtë projekt do të angazhohen 20 nxënës, të cilët do të mësojnë të qepin



## BASHKIA KORÇË

dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në teknikën e qepjes si edhe do të përmirësojnë aftësitë e tyre në praktikë për të qenë në të ardhmen profesionistë të nivelit të lartë.

Aktiviteti do të finalizohet me përzgjedhjen dhe ekspozimin e punimeve më të mira, të përgatitura nga vetë nxënësit.

**Qëllimi:** Përmirësimi dhe zhvillimi i aftësve të të rinjve në profesione të lira në fushën e modes, tepër të kërkuara në treg.

### **Objektivat:**

1. Edukimi i nxënësve me aftësi të specializuara në sektorin e modës.
2. Stimulimi i të rinjve për t'u arsimuar në fushën e modës në të ardhmen.
3. Zhvillimi i aftësive të nxënësve për t'u angazhuar në sipërmarrje artizanale, kompani industriale, studio mode, ose zhvillimi i lirë i profesionit.

### **Rezultatet:**

1. Trajnimi i 20 nxënësve për njohjen me mënyrat dhe teknikat e profesionit të qepjes
2. Përgatitja e punimeve të 20 nxënësve, promovimi dhe ekspozimi i punëve të tyre
3. Rritja e interesit të të rinjve për t'u angazhuar në profesione të lira të kërkuara në tregun e punës.

**Kostoja totale:** 316.000 Lekë

### **Titulli i projektit: Idea Bombing**

### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Duke vlerësuar mjaft pozitive eksperiencën e Bashkisë Korçë me krijimin e një bërthame brenda këtij institucioni i cili ka si qëllim zgjidhjen e problematikave në menyrë innovative me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, do të krijojë një konkurs për të përzgjedhur dhe fituar të gjitha idetë inavative që vijnë nga të rinjtë. Gjatë këtij konkursi të rinjtë që do të bëhen pjesë do të kenë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë dhe problematika që realisht kërkojnë zgjidhje jo vetëm për qytetin e Korçës por duke e shtrirë rrezën e veprimit edhe në njësitë administrative. Në fund të konkursit tre praktikant më të mira do të futen në planet e implementimit të bashkisë Korçë.

### **Qëllimi:**

- Të rritet përfshirja e të rinjve të vendimmare dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të qytetit



## BASHKIA KORÇË

- Të krijohet mundësi promovimi dhe shpalesh talentesh të reja të rinisë korçare
- Të ndjehen të përfshirë dhe të motivuar për një të ardhme të mirë të vendit

### Rezultatet:

- Realizimi i konkursit dhe tre praktikantët më të mirë.
- Thithja e ideve inovative nga të rinjtë
- Krijimi i një database më të rinj të talentuar dhe aktive në jetën e qytetit.

### Kostoja totale: 107,000 Lekë

Gjithashtu në këtë program është planifikuar edhe vlera prej 53,000 mijë lekë transferta tek organizatat e detajuara si më poshtë:

000/lekë

	Emertimi	Plan 2019
1	Transferte për Qendra Sportive Korçë sh.a	12,000
2	Transferte për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e terreneve sportive	17,000
3	Kontributi i bashkisë për futbollin sh.a	24,000
	<b>Total transferta (sport dhe argëtim)</b>	<b>53,000</b>

### 7.18. Arsimi bazë dhe parashkollor 091

**Programi: Arsimi bazë dhe parashkollor 09120**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore**

**Njësia shpenzuese Bashkia**

Buxheti i këtij program është në vlerën 16,594 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 2,476 mijë lekë
- Shpenzime kapitale në vlerën 14,118 mijë lekë

Në shpenzimet korrente janë përfshirë:



## BASHKIA KORÇË

1,776 mijë lekë për realizimin e projekteve në fushën e arsimit.

700 mijë lekë fond i planifikuar për shpenzimet e Shkollësë Maltës, të detajuara si më poshtë:

000/lekë

	Emërtimi	Plan 2019
1	Shpenz. karburanti per shkollen e Maltes	300
2	Shp. energji, uje, telefon per shkollen e Maltes	400
3	Shpenzime qeramarje ambjenti	1,296
4	Shpenzime energji dhe uje	480
	<b>Total Shp. Operative (arsimi bazë dhe parashkollor)</b>	<b>2,476</b>

### Detajimi i projektit:

**Titulli i Projektit :** Qendra ditore për fëmijë – Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë 2019

**Kohëzgjatja:** 12 muaj

### Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Qendrat ditore të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve të përditshme synojnë të risin mirëqënien e fëmijëve të grupeve të marxhinalizuara duke i aftësuar gjithashtu për jetën dhe jetën në komunitet.

**Qëllimi:** Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë

**Objektivat:** Të përmirësojë mirëqënien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë

### Rezultatet:

1. Fëmijët Romë / Egjiptiane regjistrohen në shkollen fillore dhe janë të monitoruar pas shkollës në tre qendrat ditore të fëmijëve.
2. Fëmijët Romë/Egjiptiane fitojne me shume besim ne vetevete nëpërmjet asistencës psikologjike, aktivitete sociale dhe iniciativa të tjera mbi barazine gjinore.
3. Fëmijët romë /Egjiptiane kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe janë bërë të vetëdijshëm për çështjet ne lidhje me shëndetin.



## BASHKIA KORÇË

4. Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes i prindërve Rome&Egjiptiane është rritur nëpërmjet themelimit të Komitetit të Prindërve.
5. Kapacitetet arsimore të fëmijëve janë rritur nëpërmjet kurseve të anglishtes, kompjuterit dhe kurseve të qepjes si dhe kurseve të gjuhës shqipe dhënë nënave të tyre.
6. Shëndeti i 40 fëmijëve të kequshqyer është përmirësuar si rezultat i ushqimit të shëndetshëm dhe trajnimeve mujore të prindërve mbi këtë temë nga pediatri.
7. Si rezultat i lobimit mbështetja ndaj këtij grupi përfituesish është rritur.

**Vlera e projektit:** Qendrat ditore për fëmijët janë një aspekt i rëndësishëm i shërbimeve sociale të bashkisë, që rrisin mirëqënien e këtij target grupi.

**Kosto buxheti Bashkia :** 1,776,000 lekë

### 7.19. Të moshuarit 102

**Programi: Sigurimi shoqëror 10220**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**

Ky program përfshin administrimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rezidenciale për të moshuarit.

Buxheti i këtij programi është në vlerën 5,962 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 2, e detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 1,400 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,562 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 1,200 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 200 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 4,562 mijë lekë, ku përfshihet kontributi për qendrën e Kujdesit Paliativ “Mary Potter” në vlerën 1,600 mijë lekë si dhe shpenzime operative për këtë programsi më poshtë:

000/lekë

Emërtimi

Plan 2019



## BASHKIA KORÇË

1	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	52
2	Shpenzime karburanti per Q.K.P. M.Poter	1,240
3	Shpenzime kancelarie per Q.K.P. M.Poter	80
4	Energji elektrike per Q.K.P. M.Poter	160
5	Pagesa per ujin per Q.K.P. M.Poter	80
6	Shpenz. telefon internet per Q.K.P. M.Poter	40
7	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	60
8	Sherbime te printimit & publikimit	188
9	Shpenzime pritje-percjellje	78
10	Shpenzime qeramarje ambjenti	1,584
11	Shpenzime te tjera	100
12	Shpenzime energji dhe uje	900
	<b>Total Shp. Operative +Projektet program sig shoqeror</b>	<b>4,562</b>

### Detajimi i projekteve:

**Titulli i Projektit:** “Karta për pensionistët”

**Kohëzgjatja:** Janar 2019

### Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Të moshuarit pajisen me karta pensionisti, të cilat janë të personalizuar. Me to ata marrin disa shërbime falas dhe me çmim të reduktuar.

**Qëllimi:** Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi shërbimesh falas apo me çmime të reduktuara në fusha me interes për të gjithë pensionistet e qytetit të Korçës.

**Rezultatet:** 5000 pensionistë do të përfitojnë lehtësira në shërbimin e transportit si dhe në aspektin financiar

**Objektivat:** Çdo pensionist përfiton:

- falas shërbimin e transportit urban,
- ndjekjen e ndeshjeve në stadium dhe në pallatin e sportit, ulje të çmimit të biletës në teatër në masën 50% si dhe ulje në masën 20%- 50% në disa shërbime si në njësi tregtimi, apo shërbimesh të nevojshme për moshën e tretë.
- disa shërbime e analiza mjekësore falas nga klinika në qytetin tonë.



## BASHKIA KORÇË

**Vlerat e projektit:** Projekti synon të rritë mirëqënien e të moshuarve, duke i lehtësuar nga disa shpenzime shërbimesh të përditshme, me synim rritjen e cilësisë së jetesës së tyre.

**Kosto buxheti Bashkia:** 187.500 lekë

**Titulli i Projektit :** “Qendra Komunitare për moshën e tretë” 2019

**Kohëzgjatja:** 12 muaj

**Përshkrim i përgjithshëm i projektit:**

**Qëllimi:** Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

**Objektivat:** Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

Objektiva 1: Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.

Objektiva 2: Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qendrave, punonjësit sociale dhe atij animator.

Objektiva 3: Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese

Objektiva 4: Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qendrave

Objektiva 5: Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.

**Rezultatet:** Krijimi i një ambjenti sa më mikëpritës në Qendrat Komunitare. Zvogëlimi i fenomenit të braktisjes dhe vetmisë të Moshës së Tretë. Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve sociale në qytetin e Korcës.

**Vlera e projektit:** Qendrat ditorë për moshën e tretë përmirësojnë jetën sociale të këtij target grupi, duke rritur kështu edhe cilësinë e jetës së tyre të përditshme.

**Kosto buxheti Bashkia:** 2,484,000 lekë



## BASHKIA KORÇË

### **Titulli i projektit: Dita ndërkombetare e moshes së tretë**

#### **Përshkrimi i Projektit:**

Në kuadrin e dites ndërkombëtare të të moshuarve bashkia e Korçës krahas shume projekteve të tjera për këtë grup moshë do të realizojë në këtë ditë një sërë aktivitetesh për të treguar mbështetjen dhe përkrahjen ndja kësaj shtrese. Gjatë projektit do të përcaktojmë personat e moshës së tretë të vetmuar në nevojë në qytet për të pasur një data basë të saktë. Sensibilizimi do të konsistojë në organizimin e një dreke për këta persona në nevoje. Në këtë mënyrë, ju gjendemi më pranë kësaj shtrese në nevojë duke dëgjuar problematikat e tyre.

**Qëllimi:** T'ju qëndrojmë sa më afër kësaj shtrese në nevoje , për ti bërë ata që të ndjehen sa më mirë.

**Objektivat:** Tju gjendemi sa më pranë personave të moshës së tretë të vetmuar.

**Rezultatet :** Duke ju qëndruar pranë kësaj shtrese në nevoje, bën që ata të ndjehen më të vlerësuar dhe më mirë.

**Vlera e projektit: 78,000 Lekë**

### **7.20. Sëmundje dhe paaftësi 101**

**Programi: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140**

**Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

**Njësia shpenzuese: Bashkia**

Ky program përfshin krijimin dhe administrimin shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Buxheti i këtij program është në vlerën 12,232 mijë lekë dhe nr punonjësve është 16,i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 12,056 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 176 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 10,332 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 1,724 mijë lekë.



## BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 176 mijë lekë, të cilat do të përdoren për realizimin e projekteve, si më poshtë:

000/lekë

	Emertimi	Plan 2019
1	Sherbime te printimit & publikimit	89
2	Shpenzime pritje-percjellje	75
3	Shpenzime te tjera	12
	<b>Total Shp. Operative +Projektet (Programi: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara)</b>	<b>176</b>

Detajimi i projekteve:

### **Titulli i projektit: Dita e autizmit**

#### **Përshkrimi i shkurtër:**

Me rastin e 2 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Autizmit, Bashkia Korçë do të organizojë një aktivitet sensibilizues me qëllim sensibilizimin e shoqërisë për të mirëpritur këtë shtresë në nevojë.

**Qëllimi:** Nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe kartolinave me mesazhe që kane lidhje me këtë ditë ndërkombëtare, të sensibilizojmë shoqërinë për t'i mirëpritur dhe për të mbështetur këtë shtresë në nevojë.

#### **Objektivat:**

- 1- Ndhimojmë fëmijët me aftësi ndryshe përmes mbledhjes së të ardhurave nga shitja e luleve në qytet
- 2- Njohja me problematikat e fëmijëve me aftësi ndryshe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve për qytetarët.

**Rezultatet:** Njëpëmjet aktiviteteteve sensibilizuese, shoqëria njihet nga afër me problematikat e fëmijëve me aftësi ndryshe, duke u angazhuar gjithnjë e më tepër në mbështetje dhe ndihmesë të tyre.

